



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURRENCËS-

Tiranë, më 16.09.2009

## Njoftim për shtyp

### **Autoriteti i Konkurrencës nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me Komisionin e Konkurrencës së Kosovës.**

Bashkëpunimi i vazhdueshëm midis Shqipërisë dhe Kosovës do të zgjerohet edhe më tej në fushën e konkurrencës së lirë dhe efektive.

Në këtë kuadër Kryetarja e Autoritetit të Konkurrencës, Znj. Lindita Milo (Lati) dhe Kryetari i Komisionit të Konkurrencës së Kosovës, Z. Osman Ejupi nënshkruan marrëveshjen e bashkëpunimit gjatë vizitës së një delegacioni të nivelit të lartë të Autoritetit të Konkurrencës së Shqipërisë në Kosovë në datat 14-16 shtator 2009.

Sipas marrëveshjes, palët do të bashkëpunojnë për përmirësimin e akteve ligjore dhe nën-ligjore në fushën e mbrojtjes së konkurrencës duke shkëmbyer praktikat më të mira si dhe përvojën e vazhdueshme midis dy shteteve.

Të dy këto institucione do të shkëmbejnë informacione dhe ekspertizë për hetimin e çështjeve të ndryshme si dhe do të ndërtojnë së bashku një bazë të dhënash e literature në fushën e konkurrencës.

Gjatë vizitës në Kosovë, delegacioni i Autoritetit të Konkurrencës, u takua gjithashtu edhe me kryetarin e Kuvendit të Kosovës Z. Jakup Krasniqi si dhe Ministrin e Tregëtisë dhe Industrisë Z. Lutfi Zharku. Gjatë takimit u diskutua për nevojën e sigurimit të konkurrencës së lirë dhe efektive si një kusht i domosdoshëm për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së vendeve respektive. Këta përfaqësues të lartë të Republikës së Kosovës përshëndetën ndihmën dhe mbështetjen e dhënë nga Autoriteti i Konkurrencës së Shqipërisë për konsolidimin e Komisionit të Konkurrencës së Kosovës.

Kjo marrëveshje do të ndikojë pozitivisht në përmirësimin e punës të të dy institucioneve, por edhe në përgjithësi në rritjen e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, duke pasur parasysh dëshirën e përbashkët për të marrë pjesë aktivisht në procesin ndërkombëtar të integritimit ekonomik.